



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.81/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zydi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkritazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), paraqitur kundër Koalicionit PDK-AAK-NISMA dhe subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, për shkak të vendosjes së posterave dhe njoftimeve –materjaleve për fushatën zgjedhore në shtylla dhe hapsira publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 07.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), kështu që Koalicionit PDK-AAK-NISMA, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1,600.00 (njëmijë e gjashtëqind) euro, dhe subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1,600.00 (njëmijë e gjashtëqind) euro.

II. Koalicioni PDK-AAK-NISMA dhe subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), **detyrohen** ti paguajnë gjobat e shqiptuar si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi, **nën kërcënim të përmbarimit**.

A r s y e t i m

Me datën 05.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) me të cilën pretendon se me datën 04.06.2017 në rrugën Dardania në Fushë Kosovës monitoruesit e tyre kan hasur në postere të kandidatëve për deputet nga koalicioni PDK-AAK-NISMA si dhe të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje të ngjitura në shtylla publike. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 33 paragrafi 1 pika b) i LZP-së. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 06.06.2017 me nr prtokoli 81/4, koalicioni PDK-AAK-NISMA, thekson se shkeljet nuk janë të qëllimshme dhe se kjo është bërë nga aktivist të pa informuar mirë me rregullat zgjedhore, prandal lidhur me këtë koalicioni PDK-AAK-NISMA ka evituar shkeljet dhe ka ndermar te gjitha veprimet duke i larguar te gjitha ato nga vendi ku kane qene te vendosura Si dëshmi ka bashkangjitur fotografit me të cilat shihet se janë larguar posterat nga vendi ku kanë qenë të vendosura ato.

Në përgjigje në ankesë të datës 06.06.2017 me nr prtokoli 81/5, subjekti politik LVV, thekson se pas pranimit të ankesës nga PZAP-i, LVV dega në Fushë Kosovë ka larguar të gjitha materialet në fjalë ku kanë qenë të vendosura ato. LVV në përgjigje në ankesë thekson materialet informuese të vendosura kanë qenë ne kuadër të informimit të qytetareve për të marr pjesë në Shtëpin e Kulturës në Fushë Kosoë e për të cilin aktivitet është njoftuar KKZ-ja në Fushë Kosovë, dhe se te njëjtat materjale kane elementet e duhura për tu njoftuar qytetarët mbi një aktivitet të paralajmëruar e nuk gërshetojn materjale propaganduese.

Përgjigjes në ankesë si dëshmi i ka bashkangjitur fotografit ku shihen materialet e larguar nga vendi ku kanë qenë të vendosura ato.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posterat e kandidatëve për deputet nga radhët e Koalicionit PDK-AAK-NISMA dhe materjali njoftues për fushatën zgjedhore janë vendosur në shtyllat dhe në hapsira publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton: *“Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në hapsira apo në rrugë publike.*

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e koalicionit PDK-AAK-NISMA dhe subjektit politik LVV, është shkelur neni 33 pika (b) të LZP-së, pasi që posterat e kandidatit për deputet nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, dhe materjali njoftues për fushatën zgjedhore janë të vendosura në shtylla dhe në hapsira publike.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjektet politike të koalicionit PDK-AAK-NISMA, dhe subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thot se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe se përkundër këtij fakti posterat e kandidatëve për deputet nga ky koalicion dhe materialet njoftuese për fushatën zgjedhore janë vendosur në shtylla dhe në hapsira publike. Poashtu si rrethanë Paneli mori edhe faktin se Koalicionit në fjalë dhe subjektit politik LVV, ja dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërruar veprime për të bërë përmisimin e shkeljeve ashtu që kanë tërhequr posterat dhe materialet për fushatën zgjedhore nga vendi i palejuar ku kanë qenë të vendosura ato, të cilat veprime kan ndikuar në lartësin e gjobave të shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr.81/2017 më datën 07.06.2017.



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.